ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E ISTOGUT**

Për Aktivitetin e Prokurimit : 633-26-9570-5-1-1

Sa i përket tenderit për : **RENOVIMI I PALESTRES SE SPORTEVE NE ISTOG (633-026-066-511)**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Adetex SHPK
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Muharrem Fejza
(Adresa)
PRISHTINE *10000*
(Vendi) *(Kodi postar)*
048 142 559
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

AGIM FEKA
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
adetex.ks@gmail.com
(Adresa elektronike)

25/11/2026
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Publikimi i njoftimit për kontrate : 30.10.2026
Kërkesa për rishqyrtim nga Adetex SH.P.K : 15.11.2026
Vendimi mbi pezullimin e aktivitetit te Prokurimit : 16.11.2026
Vnedim mbi refuzim pa arsyetim nga Autoriteti Kontraktues : 20.11.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.
Në përputhje me nenin 108/A të LPP-së kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim me datë 15.11.2026.
Refuzimin e kërkesës për rishqyrtim e kemi pranuar me datë 20.11.2026, duke mos e dhënë asnjë arsyetim konkret dhe te bazuar se përse pretendimet tona ankimore janë të pa bazuara.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-

092, (në tekstin e mëtejmë do të i referohemi LPP-së) dhe atë;

- Neni 1, Qëllimi.
- Neni 7, Barazia në trajtim/Jo diskriminimi;
- Neni 27 i LPP-së
- Neni 51, Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes
- Neni 52, Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës
- Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

o **Dispozitat e Rregullores nr. 002/2024 të prokurimit publik (në tekstin e mëtejmë do të i referohemi RRPP) dhe atë:**

- Neni 17, Dosja e Tenderit, par 17.
- Neni 25 i Rregullores nr.002/2024 për Prokurim Publik.
- Neni 97, Shkeljet e rënda, par 97.1 nen par (d) dhe (o).

o **UDHËZUES Nr.002/2024 PËR PROKURIMIN PUBLIK**

- Neni 9.12;

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ankesa dorëzohet në bazë të dispozitave të LPP-së konkretisht nenit 108/A.
Ku Autoriteti kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë, ku ne kemi analizuar kërkesat e juaja në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit dhe kemi konstatur se ka kritere diskriminuese/favorizuese të cilat i shkojnë përshtati *vetëm një Operatori Ekonomik të caktuar*, konkretisht në:

9.1 & 9.2) Kapaciteti teknik dhe profesional: keni kërkuar citojë:

. Një (1) Menaxher i Projektit kërkohet të jetë inxhinier (master) i diplomuar në Arkitekturë, me minimum **10 vite përvojë pune** në fushën e njëjtë ose të ngjashme. Duhet të jetë i **certifikuar për sigurinë dhe shëndetin në punë pranë MPMS-së, i certifikuar për mbrojtje nga zjarri pranë AME-së, si dhe i licencuar nga OIRK-u**."

*Kërkesa që **i njëjti individ** (Inxhinier Master i Arkitekturës) të ketë njëkohësisht **10 vite përvojë pune**, **licencë** të OIRK-ut, **certifikatë** të MPMS-së për siguri në punë DHE **certifikatë** të AME-së për mbrojtje nga zjarri, dëshmon se ky kriter është i KURDISUR drejtpërdrejt që një person specifik që punon te një operator ekonomik i favorizuar. Kjo vërtetohet edhe më shumë nga fakti se në Pikën 14 të po të njëjtit kriter kërkohet një ekspert tjetër i veçantë vetëm për Siguri dhe Shëndet në Punë (MPMS). Për një projekt renovimi të brendshëm dhe fasade, **kërkesa për 10 vite** përvojë për një individ është joproporcionale dhe kufizuese. Për më tepër, **kërkimi i njëkohshëm i 3 kualifikimeve/certifikimeve** nga fusha të ndryshme (arkitekturë, siguri në punë dhe mbrojtje nga zjarri) për të njëjtin person përbën kurdisje të këtij tenderi. **Ky kombinim absurd dhe jorelevant kriteresh** bie ndesh me nenin 69, paragrafin 2 (nën-paragrafin 2.5) dhe nenin 69.6.1 të LPP-së. Ju keni kërkuar trajtime dhe licenca speciale për individët, gjë që ligjërisht mund t'i kërkohet vetëm kompanisë si standard cilësie, por jo individit si kriter kualifikues për stafin. Për më tepër kjo është në kundërshtim flagrant me parimin e barazisë (Neni 7 i LPP) dhe par. 25.4 të RRPP-së. Andaj, kërkojmë **korrigjimin** e këtij kriteri duke ulur përvojën e kërkuar nga 10 vite në **maksimum 3 deri në 5 vite**, si dhe **heqjen e plotë** të kërkesave për certifikim pranë MPMS-së dhe AME-së për pozicionin e Menaxherit të Projektit.*

9.1 & 9.2) Kapaciteti teknik dhe profesional: keni kërkuar citojë:

*6. Një (1) inxhinier ose master i Elektroteknikës, drejtimi energjetike me minimum pesë vite përvojë pune... i certifikuar për auditimin e energjisë në ndërtesa dhe ndriçim publik, si dhe i licencuar nga OIRK-u." "7. Një (1) inxhinier ose master i Elektroteknikës, drejtimi elektronike me minimum pesë vite përvojë pune... i certifikuar për auditimin e energjisë në ndërtesa dhe ndriçim publik, si dhe i licencuar nga OIRK-u." "9. Një (1) inxhinier (master) i diplomuar në Makineri, drejtimi termoenergjetikë, me minimum pesë vite përvojë pune... i certifikuar për auditimin e energjisë në objekte, si dhe i licencuar nga OIRK-u."***.*

*Kjo paramasë është për **ekzekutimin e punimeve ndërtimore (renovimin)**, ndërsa auditimi i energjisë është shërbim konsulence që kryhet në fazën e studimit/projektimit, jo në kantier ndërtimi. Për më tepër, në të gjithë Paramasën (Pjesa C – Instalimet*

elektrike) nuk ekziston ***asnjë pozicion i ndriçimit publik rrugor****, por vetëm trupa ndriçues të brendshëm të sallës. Kërkimi i certifikimit për ndriçim publik dhe auditim energjie për dy inxhinierë elektrikë (****një energjetikë dhe një elektronikë****) plus* ***një të makinerisë*** *është Diskriminim i pastër eliminues. Kjo kërkesë si e tillë është kufizuese dhe në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së. Poashtu këto kritere aspak nuk i përgjigjen aktivitetit të prokurimit në fjalë sepse këto kritere kanë për qëllim minimin e konkurrencës, andaj si OE nuk e shohim te arsyeshme që në këtë dosje te tenderit te kerkohen certifikime të tilla. Kërkojmë* ***heqjen e plotë*** *të kërkesave për certifikim në auditimin e energjisë dhe ndriçimit publik nga Pikat 6, 7 dhe 9, si dhe* ***heqjen*** *e Pikës 7 (Inxhinier i Elektronikës) pasi punimet elektrike të paramasës mbulohen plotësisht nga një inxhinier i elektroenergjetikë ,* **9.1 & 9.2) Kapaciteti teknik dhe profesional: keni kërkuar citojë:**

"4. Një (1) inxhinier (master) i diplomuar në Ndërtimtari, drejtimi konstruktiv, ***i certifikuar si instruktor në vendin e punës..."*** *"8. Një (1) bachelor i elektroenergjetikës* ***i certifikuar nga AME për mbrojtje nga zjarri****..." "10. Një (1) bachelor ose teknik i Makinerisë (drejtimi komunikacion), me minimum tri vite përvojë pune pas diplomimit dhe* ***i trajnuar*** *për zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe të tjera." 11.Një (1) inxhinier (master) i diplomuar në Ndërtimtari, drejtimi Hidroteknikë, me minimum pesë vite përvojë pune në fushën e njëjtë ose të ngjashme, i certifikuar për menaxhimin e projekteve publike pranë MAPL-së, si dhe i licencuar nga OIRK-u. "12. Një (1) inxhinier (master) i diplomuar në Ndërtimtari, drejtimi Hidroteknikë, i* ***certifikuar për testimin e tubacioneve****..." "16. Një master i Ekologjisë dhe Mbrojtjes së Ambientit."*

Vendosja e kritereve nën ***Pikat 4, 8, 10,11, 12 dhe 16*** *të Dosjes së Tenderit përbën një devijim flagrant nga parimet themelore të prokurimit publik dhe shkel drejtpërdrejt* ***Nenin 6 (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti)****,* ***Nenin 7 (Barazia në Trajtim / Jo-diskriminimi)*** *dhe* ***Nenin 69.2.5 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (LPP)****, si dhe* ***Nenin 25.4 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (RRPP)****. Për një projekt të thjeshtë të renovimit të një palestre sportive, Autoriteti Kontraktues ka krijuar një "ekip fantazmë i cili do të jetë vetëm në letër" duke fryrë në mënyrë absurde dhe joproporcionale stafin profesional në gjithsej* ***16 inxhinierë dhe ekspertë****. Kjo strukturë nuk ka asnjë lidhje me realitetin inxhinierik të ekzekutimit të punimeve në terren, por shërben ekskluzivisht si pengesë administrative dhe* ***kufizim artificial i konkurrencës*** *për të eliminuar operatorët e kualifikuar ekonomikë dhe për të favorizuar operatorë të caktuar që posedojnë staf "në letër" me tituj dhe certifikata të sajuara. Këto kritere bien në* ***kundërshtim të plotë me Paramasën dhe Parallogarinë*** *e projektit, duke dëshmuar se janë hartuar në mënyrë selektive e jo profesionale. Konkretisht, kërkesa nën* ***Pikën 4*** *për një inxhinier master të konstruksioneve të certifikuar si "instruktor në vendin e punës" është një* ***dublim i panevojshëm*** *pasi fushëveprimi konstruktiv mbulohet tashmë nga* ***Menaxheri i Punishtes (Pika 2)****, ndërsa certifikata e instruktorit është një kushtëzim absurd pa asnjë bazë ligjore. Po ashtu, kushtëzimi nën* ***Pikën 8*** *që inxhinieri i elektroenergjetikës të ketë certifikatë nga* ***AME për mbrojtje nga zjarri*** *përbën diskriminim të pastër, sepse inxhinieri elektrik është i kualifikuar me diplomë për instalimet elektrike, ndërsa mbrojtja nga zjarri rregullohet me legjislacion të veçantë dhe mbulohet nga* ***Personi Përgjegjës për Siguri dhe Shëndet në Punë****. Edhe më flagrante është* ***Pika 10****, ku kërkohet një bachelor ose teknik i makinerisë (drejtimi komunikacion) i trajnuar për zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore, në një kohë kur në krejt Paramasën e renovimit të palestrës* ***nuk ekziston asnjë pozicion i vetëm që ndërlidhet me inxhinierinë e komunikacionit****.* ***Pika 11.****Nga konfirmimi zyrtar qe kemi marre MAPL nuk pajis personel me çertifikatë të tillë. Në të njëjtën linjë paligjshmërie është edhe* ***Pika 12****, e cila kërkon inxhinier master të hidroteknikës të certifikuar personalisht për testimin e*

*tubacioneve, kur në praktikën inxhinierike dhe sipas Paramasës (**Pjesa B, poz. 2.1**), testimi i presionit të tubacioneve kryhet nga **laboratorë ose kompani të autorizuara testuese** e jo përmes certifikatave individuale të inxhinierëve. Për më tepër, kërkesa nën **Pikën 16** për angazhimin e një Masteri të Ekologjisë dhe Mbrojtjes së Ambientit është **ekstremisht joproporcionale** për një renovim të brendshëm dhe fasadë. Duke u bazuar në argumentimet tona që u cekën më lartë, rezulton se dosja e tenderit nuk është përpiluar në harmoni me **nenin 27 të LPP-së** dhe njëkohësisht nuk është pas parasysh as **neni 17.17 i Rregullores nr.002/2024** për Prokurim Publik ku shkruan qartë që "Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve. Këto kërkesa duhet ose të eliminohen krejtësisht, ose të korrigjohen në atë mënyrë që të hiqen certifikatat e sajuara të dyfishuara e të panevojshme, duke e reduktuar stafin inxhinierik në masën reale, logjike dhe proporcionale që i përgjigjet ekskluzivisht punëve në Paramasë.* **9.1 & 9.2) Kapaciteti teknik dhe profesional:** keni kërkuar citojë:

KËRKESA 2: PUNËTORËT E KUALIFIKUAR DHE NUMRI I PUNËTORËVE NË ATK
5.Kriteri i vendosur (Kërkesa 2 – Punëtorët e certifikuar dhe pragu prej 30 punëtorësh në ATK)

"• Dy punëtorë të certifikuar për instalime të ndriçimit rrugor dhe të certifikuar për punë në lartësi;" "• Një punëtor i certifikuar për punë në lartësi me litar (punim në murin alpin)" "• Të ketë së paku 30 punëtorë të deklaruar në ATK"

*Autoriteti Kontraktues ka vendosur KRITERE që nuk kanë asnjë bazë në projektin ekzekutiv dhe në **Paramasën** e tenderit. Konkretisht, kërkesa për **dy punëtorë të certifikuar për instalime të ndriçimit rrugor** është plotësisht e paligjshme dhe e sajuar, pasi në të gjithë Paramasën (**Pjesa C)nuk ekziston asnjë shtyllë, llambë apo kabllo e ndriçimit rrugor**. Po në të njëjtën linjëabsurditeti është edhe kërkesa për një **punëtor të certifikuar për punë në lartësi me litar(alpinizëm)** për punimin në murin alpin, në një kohë kur vetë Paramasa (**Pjesa A, poz. 9.11 dhe9.6**) specifikon shprehimisht se muri alpin është një strukturë e brendshme me lartësi **9 metra** ecila **montohet me skelë lëvizëse dhe platformë pune**, e jo me litarë alpinizmi. Kërkimi i certifikatave për punë që nuk ekzistojnë ose për metoda pune të ndaluara nga vetë paramasa dëshmon qartë se këto kritere janë futur vetëm për të eliminuar konkurrencën e lirë.*

*Për më tepër, **Kërkesa 2** përmban një **kundërthënie flagrante** e cila i vë në **lajthitj**e të plotë operatorët ekonomikë dhe cenon rëndë **parimin e transparencës dhe sigurisë juridike**. Në paragrafin e parë të kësaj kërkese, Autoriteti Kontraktues kërkon që operatori ekonomik të ketë **"së paku 15 punëtorë"**, ndërsa vetëm disa rreshta më poshtë, në pikën e fundit, e detyron operatorin të dëshmojë se ka **"së paku 30 punëtorë të deklaruar në ATK"** në momentin e ofertimit. Kjo paqartësi dhe kontradiktë e drejtpërdrejtë krijon konfuzion të rëndë gjatë përgatitjes së ofertave dhe hap rrugë për vlerësim arbitrar dhe selektiv nga ana e Komisionit Vlerësues, duke u mundësuar atyre të s'kualifikojnë operatorët sipas dëshirës nën pretekstin e mosplotësimit të numrit të punëtorëve.*

*Njëkohësisht, **kriteri që punëtorët të dëshmohen vetëm përmes listës së Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), pa lejuar angazhimin e tyre me parakontratë apo marrëveshje angazhimi , bie drejtpërdrejt ndesh me Nenin 69 të LPP-së**.*

*Detyrimi i kompanive që të mbajnë 30 punëtorë në listë pagese para lidhjes së kontratës përbën **diskriminim të hapur.** Sipas **Nenit 69 të LPP-së**, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera ose të stafit*

të jashtëm për realizimin e kontratës, prandaj Autoriteti Kontraktues ***është i detyruar ligjërisht të pranojë edhe punëtorët apo stafin e angazhuar përmes parakontratave ose marrëveshjeve për angazhim në këtë projekt****.*
Duke u bazuar në këto shkelje të rënda ligjore, ***kërkojmë*** *nga Autoriteti Kontraktues* ***që menjëherë të rishikojë Dosjen e Tenderit dhe të korrigjojë ose të heqë plotësisht këto kërkesa diskriminuese nën Kërkesën 2****.*
Konkretisht, kërkojmë ***fshirjen e plotë të kushtit për punëtorë të certifikuar për ndriçim rrugor dhe punë në lartësi me litar****,* ***eliminimin e kundërthënies (15 vs 30 punëtorë)*** *dhe* ***heqjen e kufizimit që stafi të jetë vetëm me listë të ATK-së****, duke lejuar shprehimisht dëshmimin e punëtorëve dhe stafit përmes* ***parakontratave apo marrëveshjeve për angazhim*** *në këtë projekt konform* ***Nenit 69 të LPP-së****.*

Këto kritere përveq që është diskriminues është në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore sepse keni bërë shkelje të nenit 69, paragrafi 2, nen paragrafi 2.5 nenit 69.6.1 të LPP-së, i cili specifikon se Autoriteti Kontraktues mund të kërkoj ISO standarde apo Certifikime nëse janë të nevojshme për realizimin e aktivitetit të prokurimit të kërkohen **për operatorin ekonomik që të dëshmohet cilësia dhe kualiteti por jo edhe për stafin**, sepse kërkesa si e tillë është kufizuese dhe në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së. Poashtu këto kritere aspak nuk i përgjigjen aktivitetit të prokurimit në fjalë sepse këto kritere ka për qëllim minimin e konkurrencës, andaj si OE nuk e shohim te arsyeshme që në këtë dosje te tenderit te kerkohen certifikime të tilla për persona fizik,. Ne si OE konsiderojme se kjo kërkese nuk i përshtatet aspak dosjes së tenderit dhe paramases për punet që do perfundohen dhe duhen të largohen si kritere. Ju kujtojmë përsëri se certifikimet për persona fizik nuk lejohen sepse janë në kundërshtim me praktikat më të mira të prokurimit publik si dhe bien ndesh me dispozitat ligjore të lartëcekura andaj kërkojmë që këto kritere të hiqen.

Keni parasyshë se kjo mënyrë e funksionimit me kritere diskriminuse përveq minimit me kërkesa të panevojshme, i'u pamundëson shumë Operatorëve të jene pjesëmarrës cka nenkupton **favorizim për një Operator dhe demtim të buxhetit të komunës së Istogut dhe parasë publike, pasi qe minimi i konkurences me kritere diskriminuse i bënë operatoret ekonomik te cileve i'u eshte pershtatur te shkojne në maksimumin e parashikimit te ketij projekti**, gje qe nuk është hera e parë që Autoriteti Kontraktues e bënë një veprim të tillë. Andaj me këtë veprim keni bërë shkelje të par. 25.4 neni 25 i RRPP-së, citojmë: '' "Kriteret e përshtatshmërisë" dhe "kërkesat minimale të kualifikimit" së bashku karakterizohen si "Kritere të Përzgjedhjes". Kritere e Përzgjedhjes janë kërkesa që një OE duhet të përmbushë për të konsideruar i kualifikuar për dhënie të kontratës publike.

Tutje, diskriminim të skajshëm ka edhe te **Pajisje e kërkuara** në **ANEKSIN 7.** Analiza e kësaj liste të pajisjeve zbulon një tendencë të qartë dhe të dënueshme për të ngarkuar tenderin me kritere artificiale, të cilat nuk kanë asnjë lidhje me realitetin e punimeve në teren e dizajnuar ekskluzivisht për të eliminuar konkurrencëni veqojmë disa prej tyre si në vijim:

- **Një kokë tërheqëse me vinç, me kapacitet maksimal 11 ton** *(Kjo makineri e rëndë industriale nuk ka asnjë lidhje me punimet e Paramasës. Në të gjithë projektin e renovimit të palestrës nuk ka asnjë element strukturor parafabrikat të rëndë, tra betonarme apo pajisje që kërkon kokë tërheqëse me vinç 11 ton. E vetmja pajisje që kërkon kran në Paramasë janë 3 njësi të jashtme të klimatizimit VRF në Pjesën D, poz. 1.4, të cilat peshojnë disa qindra kilogramë dhe vendosen me një autovinç të zakonshëm ose me kamionin me kran të kërkuar më lart. Kjo kërkesë është vendosur*

ekskluzivisht për të eliminuar konkurrencën në kundërshtim me Nenin 69.6.1 të LPP-së). Kërkojmë të hiqet plotësisht nga lista e makinerisë së kërkuar.

- **" një gjysmë-rimorkio;"** dhe **"• një kamion gjysmë-rimorkio për bartjen e makinerive"** *(Kërkimi i njëkohshëm i një gjysmë-rimorkioje dhe një kamioni gjysmë-rimorkio për bartjen e makinerive është krejtësisht joproporcional dhe absurd në raport me Paramasën. Në të gjithë projektin nuk ka asnjë makineri të rëndë ndërtimore që kërkon kamion gjysmë-rimorkio (trajler) për transportim, pasi e vetmja makineri gërmuese në listë është një mini-eskavator nën 990 kg, i cili transportohet me një kamionetë të zakonshme ose rimorkio të lehtë. Po ashtu, materialet e renovimit (pllakat e qeramikës, parketi, kanalet e ajrimit, llambat dhe bojat) nuk transportohen në kantier urban me gjysmë-rimorkio. Ky dyfishim i mjeteve të rënda transportuese ka për qëllim të vetëm favorizimin e një kompanie që rastësisht i posedon këto mjete në vete, duke shkelur Nenin 7 të LPP-së).*

- **Një mini-eskavator me peshë deri në 990 kg;**

(Vendosja e kufirit fiks dhe arbitrar "me peshë deri në 990 kg" është shembull klasik i diskriminimit dhe favorizimit të një makine specifike. Në Paramasë, Pjesa B, poz. 4.6, parashihet gërmimi i kanalit për kanalizimin fekal dhe atmosferik në dheun e kategorisë IV me vëllim prej 720 m³. Një operator ekonomik që posedon një mini-eskavator me peshë 1.5 ton, 2 ton ose 3.5 ton e kryen këtë punë shumë më shpejt, më sigurt dhe me kosto më të ulët
sesa një mini-eskavator lodër nën 990 kg, mirëpo s'kualifikohet padrejtësisht sepse e tejkalon kufirin e vendosur enkas për një makinë të një operatori të caktuar, në shkelje të Nenit 7 të LPP-së). Kërkojmë të korrigjohet ose t*ë* hiqet plotësisht nga lista e makinerisë së kërkuar.
 Një kamionetë me kabinë të dyfishtë;

*(Kushtëzimi që kamioneta të jetë detyrimisht "me kabinë të dyfishtë" nuk ka asnjë lidhje teknike me realizimin e punimeve të Paramasës. Për transportin e materialeve të lehta ose veglave të punës nuk ka kurrfarë rëndësie nëse kabina e kamionetës ka një rend apo dy rende ulësesh. Përjashtimi i operatorëve ekonomikë që posedojnë kamionetë standarde me kabinë të thjeshtë ose furgon transportues dëshmon se specifikat janë shkruar duke shikuar mjetin konkret të një kompanie të preferuar, duke shkelur barazinë e trajtimit të përcaktuar në Nenin 7 të LPP-së).*Kërkojmë **korrigjimin** duke hequr specifikimin *"me kabinë të dyfishtë"* dhe duke lejuar çdo automjet të lehtë transportues.

SHKELJET NË PARAMASË DHE PARALLOGARI –

Konkretisht në përshkrimet teknike të pozicioneve të punëve (fletët/sheet-at **Pjesa A** dhe **Pjesa D**
Nenit 28, **paragrafi 6** të LPP-së, ndalon rreptësisht përmendjen e **markave tregtare**, **modeleve** dhe numrave specifikë të prodhuesve në specifikimet teknike, e sidomos pa fjalët **"ose ekuivalent".**
Pjesa A, **poz. 9.6:** "Paisja duhet të posedojë standardin TÜV-SÜD EN1004-1-2 / Z1 091172 0027 Rev.00"
Pjesa A, poz. 9.4: "Tastiera komanduese për komandim me semafor Model CU 10 dhe për shënimin e kohës së aksionit Model CU 20"
Pjesa D, **poz. 1.2, 1.5, 1.6, 1.11:** "Njesia e jashtme DVS S2 Standard AM780AXVAGH1EU... Hydro Unit AM500FNBDEH/EU... Kontroller muri TIP: MWR-WW10N... Degezime MXJ-YA3419M..."*
Pjesa D, **poz. 3.1 dhe 3.2:** "Bojleri... tip Vitocell 100-B CVBA 500L... Paneli Diellor Solar... lloji Vitosol 100-FM tip SV1F"
Pjesa A, **poz. 3.3, 4.3, 4.4, 7.8:** "Stirodur", "Knauf", "Alukobond"

Kodi serial i një prodhuesi të vetëm (poz. 9.6): Kodi *"Z1 091172 0027 Rev.00"* nuk është standard teknik evropian (standardi është EN 1004-1-2), por është **numri serial i certifikatës së një prodhuesi të vetëm të skelave** në bazën e të dhënave të TÜV-SÜD! Vendosja e numrit serial të certifikatës së një prodhuesi specifik në tender publik është shkelje e rëndë ligjore. Po ashtu, kodet *AM780AXVAGH1EU* **(Samsung),** *Vitocell 100-B* **(Viessmann),** *Model CU 10/CU 20* dhe markat *Stirodur,* ***Knauf, Alukobond*** janë vendosur pa shprehjen ***"ose ekuivalent"***.

9.6. Furnizimi dhe montimi i skelës lëvizëse... Paisja duhet të posedojë standardin TÜV-SÜD EN1004-1-2 / Z1 091172 0027 Rev.00"

(Autoriteti Kontraktues ka bërë një manipulim teknik shumë të rëndë duke bashkangjitur pas standardit evropian EN 1004-1-2 kodin ***"Z1 091172 0027 Rev.00"****. Ky kod nuk është standard evropian apo ndërkombëtar, por është* ***numri serial unik i certifikatës individuale të një prodhuesi të vetëm të skelave*** *në regjistrin e institutit TÜV-SÜD. Me këtë veprim, asnjë prodhues tjetër në botë — edhe nëse prodhon skela të certifikuara sipas të njëjtit standard evropian EN 1004-1-2 — nuk mund ta përmbushë këtë kërkesë, sepse numri serial Z1 091172 0027 Rev.00 i përket ekskluzivisht një marke/prodhuesi të caktuar. Kjo përbën shkelje flagrante të Nenit 7 dhe Nenit 28, paragrafi 6 të LPP-së).*

Kërkojmë **fshirjen e menjëhershme** të numrit serial të certifikatës **/ Z1 091172 0027 Rev.00** nga përshkrimi i pozicionit 9.6 në Paramasë, duke lënë vetëm kërkesën për standardin evropian **EN 1004-1-2 ose ekuivalent**.

2. Pozicioni i vendosur në Paramasë (Fleta "Pjesa A" – Punët Ndërtimore-Artizanale, Kapitulli IX, Pozicioni 9.4):

"9.4. Furnizimi dhe montimi i tastierës komanduese për komandim me semafor Model CU 10 dhe për shënimin e kohës së aksionit Model CU 20..."

*(Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar emërtime të sakta të modeleve të një prodhuesi specifik (****Model CU 10*** *dhe* ***Model CU 20) pa përdorur fjalët "ose ekuivalent"****. Sipas Nenit 28, paragrafi 6 të LPP-së, specifikimet teknike nuk guxojnë t'u referohen modeleve të caktuara që favorizojnë prodhues ose furnizues të veçantë, dhe edhe në rastet e jashtëzakonshme kur lejohet përmendja e tyre, ajo duhet të shoqërohet detyrimisht me shprehjen* ***"ose ekuivalent"****).*

Kërkojmë **korrigjimin** e pozicionit 9.4 duke fshirë emërtimet e modeleve specifike (*Model CU 10* dhe *Model CU 20*) ose duke shtuar detyrimisht fjalët **"ose ekuivalent"**.

3. Pozicionet e vendosura në Paramasë (Fleta "Pjesa D" – Instalimet Termoteknike dhe Klimatizimi, Kapitulli I, Pozicionet 1.2, 1.5, 1.6 dhe 1.11):

"1.2. Njesia e jashtme DVS S2 Standard AM780AXVAGH1EU..." "1.5. Hydro Unit AM500FNBDEH/EU..." "1.6. Kontroller muri TIP: MWR-WW10*N..." "1.11. Degezime MXJ-YA3419M..."

(Këto pozicione ndodhen në fletën ***Pjesa D (Kapitulli I)*** *të Paramasës dhe Parallogarisë. Të gjitha kodet e listuara më sipër (AM780AXVAGH1EU, AM500FNBDEH/EU, MWR-WW10*N, MXJ-YA3419M) janë* ***kode të drejtpërdrejta të katalogut të prodhuesit Samsung*** *për sistemet e klimatizimit VRF/DVM. Përcaktimi i kodeve të katalogut të një prodhuesi të vetëm, duke mos lejuar prodhuesit e tjerë botërorë të klimatizimit (si Daikin, Mitsubishi, LG, Gree, Midea etj.) dhe duke mos e vendosur shprehjen* ***"ose ekuivalent"****, e kufizon konkurrencën te përfaqësuesi/distributori i një marke të vetme, në kundërshtim të hapur me Nenin 28.6 të LPP-së).*

Kërkojmë **korrigjimin** e pozicioneve 1.2, 1.5, 1.6 dhe 1.11 në Pjesën D duke larguar kodet e katalogut të prodhuesit Samsung dhe duke vendosur vetëm parametrat teknikë (kapaciteti ftohës/ngrohës në kW, koeficienti COP/EER) me shprehjen **"ose ekuivalent"**.

4. Pozicionet e vendosura në Paramasë (Fleta "Pjesa D" – Instalimet Termoteknike, Kapitulli III, Pozicionet 3.1 dhe 3.2):

"3.1. Bojleri për përgatitjen e ujit të ngrohtë sanitar... tip Vitocell 100-B CVBA 500L..." "3.2. Paneli Diellor Solar... lloji Vitosol 100-FM tip SV1F..."

(Këto pozicione në fletën ***Pjesa D (Kapitulli III)*** *të Paramasës dhe Parallogarisë. Emërtimet* ***"Vitocell 100-B CVBA 500L"*** *dhe* ***"Vitosol 100-FM tip SV1F"*** *janë marka të regjistruara*

*dhe modele specifike të prodhuesit gjerman **Viessmann**, të vendosura **pa shprehjen "ose ekuivalent"**. Kjo detyron çdo ofertues që të furnizohet ekskluzivisht nga importuesi i kësaj marke, duke shkelur barazinë e trajtimit (Neni 7 i LPP-së) dhe rregullat për hartimin e specifikimeve teknike (Neni 28.6 i LPP-së)*

Këto kërkesa bien në kundërshtim me **nenin 7**, paragrafi **1,2,3,4 dhe 6 të LPP-së**, pasiqë në këtë paragraf parashihet qartë se operatorët ekonomik nuk mund të diskriminohen në asnjë mënyrë dhe në asnjë variant. *Mënyra e kërkesës për këto pajisje është tejet diskriminueseër faktin se mund të kërkohet një minimumi një kapaciteti tëi tonazhës kaq të madh dhe pajisje kaq të specifikuara sikur këto të lartëpërmendura*

Ne konsiderojmë gjithashtu se Dosja e Tenderit nuk është përgatitur sipas nenit 27 të LPP-së pasi aty shkruan qartë se Dosja e Tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk:

- Kufizon konkurrencën në mesin e Operatorëve Ekonomik, pse
- **Diskriminon kundër ose vepronnë favour të një ose më shumë Operatorëv Ekonomik**

Ne vlerësojmë se këto pajisje që janë kërkuar ngaa na e AK-së janë favorizuese/diskriminuese pasi që nga paramasa shihet që nuk egziston ndonjë punë e cila nuk mund të kryhet me pajisje tjera dhe jo të *vendosen pajisjet e një operatori ekonmomik që i keni pergatitur këtë tender andaj kërkojmë nga autoriteti kontraktues ti largojë këto kërkesa sepse nuk janë asgjë më shumë **se sa kërkesa favorizues/diskrimiues dhe abuzim i detyrës zyrtare.***

Këto kërkesa bien ndesh plotësisht me nenin 7 të LPP-së përkatësisht paragrafët 1, 2, 3 dhe 6. Paragrafi 1 i nenit 7 parasheh qartë që *"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente".*

Me këto kërkesa, jo që nuk mund të ketë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik por do të ketë diskriminim të hapur qysh në start të këtij aktiviteti të prokurimit dhe nuk mund të ketë konkurrencë të hapur. *Paragrafi 6 i dispozitës së nenit 7 parasheh qartë : Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit".*

*Keni parasyshë se kjo mënyrë e funksionimit me kërkesa diskriminuse përveq minimit me kërkesa të panevojshme, i'u pamundëson shumë Operatorëve të jene pjesëmarrës cka nenkupton **favorizim për një Operator dhe demtim të buxhetit të komunës së Istogut dhe parasë publike, pasi qe minimi i konkurences me kritere diskriminuse i bënë operatoret ekonomik te cileve i'u eshte pershtatur te shkojne në maksimumin e parashikimit te ketij projekti**, gje qe nuk është hera e parë që Autoriteti Kontraktues e bënë një veprim të tillë. Andaj me këtë veprim keni bërë shkelje të par. 25.4 neni 25 i RRPP-së, citojmë: "Kriteret e përshtatshmërisë" dhe "kërkesat minimale të kualifikimit" së bashku karakterizohen si "Kritere të Përzgjedhjes". Kritere e Përzgjedhjes janë kërkesa që një OE duhet të përmbushë për të konsideruar i kualifikuar për dhënie të kontratës publike.*

Me këto kërkesa nuk mundësohet pjesëmarrje e gjerë e operatorëve ekonomik, por në këtë mënyrë është kufizuar tej mase konkurrenca dhe këto kërkesa janë drejtpërdrejtë jo në harmoni me lëndën dhe qëllimin e këtij aktiviteti të prokurimit sepse kur kufizohet konkurrenca me kërkesa të pa nevojshme atëherë edhe çmimi ofertues i operatorëve ekonomik që eventualisht mund ti përshtaten këto kërkesa, automatikisht është shumë më i lartë sepse nuk kanë konkurrencë dhe faktikisht determinohet fituesi me këto kërkesa.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë, rezulton se dosja e tenderit nuk është përpiluar në harmoni me **nenin 27 të LPP-së** dhe njëkohësisht nuk është pas parasysh as **nenin 17.17 i Rregullores nr.002/2024** për Prokurim Publik ku shkruan qartë që *"Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve".*

Duke u bazuar në të gjitha këto kërkesa diskriminuese-favorizuese dhe në ato dëshmi të kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: *Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë*.
Kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues, Komuna e Istogut që ta bëjë Korigjimin e këtyre pajisjeve përmes formularit B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara dhe pastaj ti permirësojë pajisjet e vendosura në kundërshtim me dispozitat ligjore.
Andaj e kundërshtojmë Njoftimin për Kontratë të datës 03.11.2026, sepse është ne shkelje të dispozitave të lartë cekura dhe në shkelje të dispozitave të nen par (d) dhe (o), të par 97.1 të nenit 97 të rregullores RRPP 02/2024, për shkak të mos respektimit dhe shkeljeve të parimeve themelore të prokurimit publik të përcaktuar me LPP dhe ne trajtim jo të barabartë të ofertuesve gjatë ushtrimit të procedurave të prokurimit.
Dhe, rrjedhimisht, duke pasur parasysh se, jemi palë me interes juridiko material ne kuptim të nenit 4.1.26 të LPP-se, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues, që Kërkesën për Rishqyrtim të trajton në përputhje të plotë me dispozitat e LPP-se dhe rregulloreve në fuqi dhe argumenteve të prezantuara dhe ta korigjojë gabimin, me plotë kuptimin e fjalës plotësisht diskriminues, tendencioz dhe të njëanshëm duke nxjerrë vendim:

Prandaj, duke u bazuar në faktet, argumentet, arsyetimet, provat materiale, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që pas trajtimit të Kërkesës për Rishqyrtim tonë të nxjerr:

VENDIM

- Të nxjerrë vendim meritor me të cilin të aprovoj Ankesën si të bazuar të paraqitur nga **"Adetex SH.P.K"**

- Të korrigjojë Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit përkriteret dhe pajisjet e kërkuara.

Mbetemi me shpresë se Kërkesa për Rishqyrtim të shqyrtohet pozitivisht.
Me respekt,

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet kufizimi i konkurrencës duke na dëmtuar nga pjesëmarrja në këtë aktivitet prokurimi

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë"*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës.*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve.*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.*
f) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*